



Unterricht in Heimatlicher Sprache und Kultur (HSK)
Informationen für Eltern

Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut (GJKA) Informata për prindër

Shumë njerëz jetojnë sot në një rreth multikulturor. Kjo vlen si për përditshmërinë private ashtu edhe për atë profesionale. Për këtë arsye përkrahja e kompetencave gjuhësore dhe multikulturore është një nga detyrat themelore të shkollës. Këtë qëllim e ndjek edhe mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut (GJKA), i cili përkrahët nga drejtoria e arsimit. Në Kantonin e Cyrihut aktualisht këtë ofertë e shfrytëzojnë mbi dhjetë mijë nxënës.

Çka është mësimi në GJKA?

Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut (GJKA) është një ofertë në shumë gjuhë jogjermane, si plotësim i mësimin në shkollën fillore. Në këtë mësim fëmijët dhe të rinjtë dygjuhësorë i zgjerojnë kompetencat në gjuhën e tyre amtare (e quajtur edhe „gjuhë e parë“). Ata marrin këtu njohuri edhe për kulturën e tyre të origjinës, p.sh., mbi historinë, gjeografinë, literaturën dhe traditën.

Dobia e mësimin në GJKA

- Fëmijët dhe të rinjtë i thellojnë kompetencat e tyre në gjuhën amtare – në të kuptuar dhe në të folur, në të lexuar dhe në të shkruar.
- Kush e zotëron mirë gjuhën e vet amtare, e mëson gjermanishten si gjuhë të dytë dhe gjuhët e tjera më lehtë.
- Zotërimi i mirë i një gjuhe plotësuese sjell përparësi në fushën profesionale.
- Lehtësim i kontakteve me vendin e origjinës (arsimim i mëtejshëm, kthim, punë në profesion).
- Mësimi i GJKA e përkrah parimisht suksesin mësimor në shkollën publike, ngase ai e forcon vetëbesimin dhe i zgjeron njohuritë për botën.
- Fëmijët e njohin dhe e mësojnë kulturën e origjinës së prindërve të tyre dhe reflektojnë për situatën e tyre në Zvicër. Kjo i përkrahë kompetencat e tyre që të lëvizin në kultura të ndryshme dhe të integrohen në shoqërinë mikpritëse.



Si mund ta përkrahin prindërit zhvillimin gjuhësor të fëmijës së tyre shumëgjuhësor?

- Flisni me fëmijën tuaj në gjuhën, të cilën ju në mënyrë spontane dhe natyrore e flisni dhe të cilën e dini më së miri – të shumtën e herave kjo është gjuha amtare. (Është i gabuar supozimi se një fëmijë e ka parimisht më lehtë në shkollë nëse prindërit e tij me gjuhë amtare të huaj flasin me të gjermanisht.)
- Gjatë bisedës me fëmijën tuaj menjanoni që ta përzieni gjuhën amtare me gjuhën gjermane. Rrini edhe atëherë te gjuha amtare edhe kur fëmija përgjigjet në gjermanisht. Por lejone fëmijën tuaj të zgjedh vetë se në cilën gjuhë dëshiron të përgjigjet.
- Nëse babai dhe nëna flasin gjuhë të ndryshme, atëherë këtë mund ta bëjnë edhe me fëmijën e tyre. Edhe këtu janë me rëndësi rregulla të qarta: „Nëna flet këtë gjuhë, babai atë, kur hamë bashkë bukë flasim kështu.“
- Mos lejoni të gaboheni nga krizat: Ndoshta fëmija juaj flet në një fazë vetëm gjermanisht, edhe pse e kupton gjuhën amtare. Nëse ju vetë mbeteni në mënyrë konsekuente te gjuha amtare, fëmija edhe më tutje mëson si dëgjues – dhe sigurisht më vonë do ta flasë këtë gjuhë përsëri.
- Përkrahni gëzimin e fëmijës suaj në gjuhën amtare- përmes asaj që ju tregoni nga përditshmëria diçka dhe e dëgjoni atë, shikoni bashkërisht libra me fotografi, flisni rima, këndon, tregoni ngjarje ose i lexoni diçka.
- Krijoni rregullisht situata në të cilat fëmija juaj pa ndihmë në përkthim përmes një të treti, duhet të përdorë gjuhën amtare (pushimet te të afërmit etj.)
- Kujdesuni që fëmija juaj që nga fëmijëria të ketë shumë kontakte me gjuhën gjermane. Të jeni edhe vetë ju të hapur për gjuhën gjermane dhe ta mësoni atë. Ju jeni idol për fëmijën tuaj.
- Dërgone fëmijën tuaj (mundësisht që prej kopshtit parashkollor) në mësimin e gjka dhe lini rregullisht të tregojë çka mëson fëmija atje.
- Përkujdesuni për kontakte të rregullta me mësimdhënësit e klasës së rregullt dhe me atë të mësimin të GJKA.

Organizimi i mësimin të GJKA

Kush jep mësim?

Mësimi organizohet ose nga ambasadat (gjegjësisht konsullatat) e vendeve të origjinës ose nga bartësit privat. Ai është i lejuar me ligj si mësim plotësues në shkollën fillore. Mësuesit e GJKA punojnë bashkërisht me mësuesit e klasëve të rregullta. 1-2 në vit ata i ftojnë prindërit në mbrëmje informative.

Lajmërimi i fëmijës

Mësimi mund të vijohet prej klasës së 1 të shkollës fillore. Lajmërimi bëhet përmes prindërve në faqen www.vsa.zh.ch/hsk/anmeldung. Prindërit mund të kërkojnë, nëse është e nevojshme, tek mësimdhënësi një fletëparaqitje për lajmërim në formë të letrës, ose drejtpërdrejt të drejtohen tek personi i cili koordinon mësimin e GJKA. Adresën kontaktuese shikojë poshtë.



Koha e mësimi

Nxënëset dhe nxënësit e vijojnë mësimin gjatë 2-4 orëve në javë. Ai zhvillohet pjesërisht në kohët e mësimi të rregullt të shkollës publike, por në të shumtën e herave në vazhdim të përfundimit të mësimi ose të shtunën.

Vendi i mësimi

Mësimi i GJKA zhvillohet në lokalet e shkollës publike, sipas mundësive sa më afër vendbanimit të fëmijëve.

Nota në dëftesën e shkollës fillore

Mësimdhënësi i GJKA i vlerëson sukseset dhe përparimet mësimore të fëmijëve në mësimin e GJKA me një notë nga 1-6 dhe pastaj e shënon atë në dëftesë. Mësimdhënësi i klasës e shënon pastaj këtë notë në dëftesën e shkollës fillore. Shumica e vendeve të origjinës e njohin në mënyrë oficiele vijimin e mësimi të GJKA.

Drejtoria e Arsimit e Kantonit të Cyrihut

Në bashkëpunim me bartësit e kurseve të Gjuhës dhe Kulturës së Atdheut (GJKA).

Adresat kontaktuese / Kontaktadresse

Albanischer Lehrer- und Elternverband „Naim Frashëri“

Herr Nexhat Maloku

Hagenbuchrain 32

8047 Zürich

076 569 20 80

nmaloku@smile.ch

www.lapsh-zh.ch

Fassung Oktober 2013